

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “Blerje produkte ushqimore, per nevojat e Spitalit Korce ne ndare me lote”, Marreveshje kuader me nje operator ekonomik – ku te gjitha kushtet jane te percaktuara – me afat 1(nje) vjecar (12 muaj).

Loti 1 “Blerje bulmeti dhe nenproduktet e tij, per nevojat e Spitalit Korce”, Marreveshje kuader me nje operator ekonomik – ku te gjitha kushtet jane te percaktuara – me afat 1(nje) vjecar (12 muaj).

Loti 2 “Blerje veze, per nevojat e Spitalit Korce”, Marreveshje kuader me nje operator ekonomik – ku te gjitha kushtet jane te percaktuara – me afat 1(nje) vjecar (12 muaj).

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** 15800000-6  
Produkte ushqimore te ndryshme

**VLERA E FONDIT LIMIT:** Vlera e perlllogaritur per te dy lotet eshte **7,753,464** (shtatemilion e shtateqind e pesedhjete e tre mije e katerqind e gjashtedhjete e kater) leke pa TVSH, ose **9,304,156.8** (nentemilion e treqind e kater mije e njeqind e pesedhjete e gjashte pike tete) leke me TVSH, , vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit, e ndare sipas loteve si me poshte;

Loti 1 “Blerje bulmeti dhe nenproduktet e tij, per nevojat e Spitalit Korce”, Marreveshje kuader me nje operator ekonomik – ku te gjitha kushtet jane te percaktuara – me afat 1(nje) vjecar (12 muaj), me fond limit **7,068,240** (shtatemilion e gjashtedhjete e tete mije e dyqind e dyzet) leke pa TVSH, ose **8,481,888** (tetemilion e katerqind e tetedhjete e nje mije e teteqind e tetedhjete e tete) leke me TVSH.

Loti 2 “Blerje veze, per nevojat e Spitalit Korce”, Marreveshje kuader me nje operator ekonomik – ku te gjitha kushtet jane te percaktuara – me afat 1(nje) vjecar (12 muaj), me fond limit **685,224** (gjashteqind e tetedhjete e pese mije e dyqind e njezet e kater) leke pa TVSH, ose **822,268.8** (teteqind e njezet e dy mije e dyqind e gjashtedhjete e tete pike tete) leke me TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor Drejtoria e Sherbimit Spitalor Korce, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të L.PP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

## 2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

### 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” dhe Licencë të kategorisë “II.1.B-Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018).

#### **Shënim:**

Operatori ekonomik në zbatim të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Per ushqimin”, konkretisht neni 19, për çdo stabiliment që disponon (minimalisht duhet të disponojë 1 (një) stabiliment, (pronesi dhe/ose qira) të paraqesë tabelën me informacion si më poshtë:

Nr.	Vendodhja	Statusi	Nr. i regjistrimit të posacem
1		Pronesi/qira/perdorim	
Etj.		Pronesi/qira/perdorim	

Detyrimisht duhet që çdo stabiliment duhet të jetë i pajisur me licence perkatese. Në rast të konstatimit të ushtrimit të stabilimentit jo në përputhje me këto nën do të referohen pranë AKU për ndjekjen e procedurave perkatese administrative sipas nenin 68 të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Per ushqimin”.

*Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 41, pika 4, gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; si dhe me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Operatorët Ekonomik duhet të zbatojnë kërkesat e Ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, për furnizimin/shpërndarjen me produktet ushqimore në ambjentet e përcaktuara, si dhe për ruajtjen e higjenes dhe mjediset, kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit.*

### 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (3 viteve fundit nga data e hapjes së ofertave të tenderit) 2021-2022-2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit të lotit/loteve për të cilin/cilat konkuron. Për këto operatori ekonomik duket të dorëzojë vërtetim lëshuar nga Dega e tatimit Taksave.

*Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe Ligji Nr. 9920, datë 19.5.2008 Per Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar, Ligji Nr.8438, datë 28.12.1998 Per tatimin mbi të ardhurat si dhe Udhezimi Nr.5, datë 30.01.2006 Per Tatimin mbi të ardhurat i ndryshuar pika 3.12 “Deklarimi tatimor dhe Llogaritja perfundimtare e detyrimit”.*

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:*

Fondi limit Loti 1 është **7,068,240** leke pa TVSH,

**40% e 7,068,240 = 2,827,296 leke pa TVSH.**

Pra vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar (2021-2022-2023) duhet të jetë jo më e vogël se **2,827,296** leke pa TVSH.

Fondi limit Loti 2 është **685,224** leke pa TVSH,  
**40% e 685,224 = 274,089.6 leke pa TVSH.**

Pra vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar (2021-2022-2023) duhet të jetë jo më e vogël se **274,089.6 leke pa TVSH.**

*Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës.*

*Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.*

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.*

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e publikimit të njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit të lotit/lotëve për të cilin/cilat oferton.**

Shënim\*: Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 20% do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme të lotit/lotëve që ofertohet. Kur konkurohet për më shumë se 1 lot, 20% do të aplikohet mbi shumën totale të vlerës së pritshme të kontratave për lotet që konkurrohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Fondi limit Loti 1 është **7,068,240** leke pa TVSH,  
**20% e 7,068,240 = 1,413,648 leke pa TVSH.**

Pra vlera për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, te jetë në një vlerë jo më të vogël se **1,413,648** leke pa TVSH.

Fondi limit Loti 2 është **685,224** leke pa TVSH,  
**20% e 685,224 = 137,044.8 leke pa TVSH.**

Pra vlera për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, te jetë në një vlerë jo më të vogël se **137,044.8** leke pa TVSH.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 në kushtet kur kjo procedurë prokurimi është procedurë e hapur të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** në adresën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

***Argumentimi:** Në bazë të nenit 41 pika 4, të VKM-së nr. të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se kanë kapacitetet teknike për ekzekutimin e kontratës, pra operatorët ekonomik duhet të vërtetojnë që kanë mjetet e duhura për ushtrimin e veprimtarisë, i cili duhet të funksionojë në bazë të dispozitave ligjore në fuqi duke paraqitur nje deklaratë.*

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë **të paktën 1 (nje)** automjet ATV (frigorifer), për transportin e mallrave, të cilin duhet ta ketë në pronësi ose me qira. Per sa me sipër operatori ekonomik te paraqes nje deklaratë perkatëse sipas formatit te mëposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtes	Statusi
1				Pronesi/qira/perdorim

**Shenim:**

Per mjetin me status perdorimi qira/hua perdorje te disponohet kontrata noteriale perkatëse mes qiradhenesit dhe qiramarrësit.

Për këtë mjet duhet të paraqesi librezë qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjetit.

**Per mjetin qe do te deklarohet, detyrimisht do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor per te gene pjese e planit te zbatimit te kontrates.**

***Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet për kryerjen e transportit të ushqimineve për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.*

2.3.4 Operatori/et ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi, si dhe shërbimin e transportit duhet të ketë minimalisht të punësuar, si më poshtë:

Stafi	Nr.
Shofer	1
Punetore të thjeshtë	1
<b>Total</b>	<b>2</b>

- Për punonjësit e punësuar shofer të paraqitet kontratë pune perkatese si dhe leje drejtimi.
- Për punonjësit e punësuar punetore të thjeshtë të paraqitet vetëm kontratë pune perkatese.
- Operatori ekonomik të paraqes deklarate në lidhje me stafin që disponon sipas formatit të mëposhtëm:

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit të marrëdhënieve të punës

#### **Shënim:**

Në lidhje me kërkesën që OE të disponojë 1 person me profesionin shofer, OE paraqet në staf të 1 punonjësi, që jo domosdoshmërisht është i regjistruar në listëpagesat e shoqërisë si shofer, por që disponon lejen e drejtimit të tipit B dhe mund të realizojë me sukses shërbimin e transportit të artikujve ushqimorë, brenda afateve të ekzekutimit të kontratës.

#### **Per punonjesit qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te gene pjese e planit te zbatimit te kontrates.**

*Argumentimi:* Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Referuar natyrës së mallrave që kërkohen të prokurohen sic janë ushqime për 23 IEVP dhe institucione të tjera është e nevojshme pasja e një stafi të kualifikuar. Ky numer minimal është kërkuar duke u bazuar në nevojën për realizimin e kontratës së furnizimeve të mallrave që kërkohen.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës duhet të vetdeklarojë se, nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore. Në rast se operatori ekonomik pjesëmarrës do të shpallet fitues, përpara lidhjes së marrëveshjes kuadër ka detyrimin të paraqesë dokumentacionin provues në lidhje me kontrollin e fundit të ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, për të provuar ushtrimin e aktivitetit konform kërkesave ligjore.

*Argumentimi:* Në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ....”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

2.3.6 Në rast se operatori pjesëmarrës nuk është prodhues, por do të përmbush kërkesat e AK me kontrata furnizimi për të gjithë artikujt objekt prokurimi, atëherë këto kontrata duhet të deklarohen sipas tabelës nr 1. Operatorët palë të këtyre kontratave furnizimi duhet ta ushtrojnë aktivitetin e tyre konform legjislacionit në fuqi .

**Tabela 1**

Nr	Emertimi i Artikullit	Prodhuesi/Distributori i autorizuar	Data e nënshkrimit të fillimit të kontratës së furnizimit	Data e përfundimit të afatit të kontratës së furnizimit
1				
2				
3				
4				
5				
Etj				

**Shënim:**

Kontratat e furnizimit për të gjithë artikujt objekt prokurimi **që do të deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor.**

*Argumentimi:* Në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ...”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

2.3.7 Operatorët ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesin **-Raport/Fletë Analizë Fiziko-Kimike dhe Raport/ Fletë Analizë Mikrobiologjike**, të lëshuar nga një laborator i referencës ose i akredituar sipas legjislacionit në fuqi. Të cilat të jenë të lëshuara brenda 30 (tridhjetë) ditëve, para datës së hapjes së ofertave. Këto **Raport/Fletë Analiza** duhet të paraqiten origjinale, ose fotokopje të noterizuara, dhe të ngarkohen në SPE:

Keto flete analiza duhet te jene per të gjithë artikujt objekt prokurimi :

Loti 1“Blerje bulmet dhe nënproduktet e tij.”

dhe

“Blerje veze”

*Argumentimi:* Në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ...”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

## SPECIFIKIMET TEKNIKE:

### PRODHIME BULMETI

#### **1. DJATHI I BARDHË FETË**

**Bazuar ne SSH 1410:1987 ose ekuivalentin e tij.**

*Bazuar në Urdhrin e Ministrisë së Bujqësisë Nr 645, dt. 23.12.2016, “Për zëvendesimin e aneksit i, te urdhrin nr.234, dt. 20.05.2014 per miratimin e rregullores “mbi kriteret mikrobiologjike per produktet ushqimore”.*

#### **Klasifikimi**

- **Lloji: Djathë fetë lope, cilësi e parë.**

#### **Kërkesat cilësore**

Treguesit shqisorë:

- *Forma:* prizëm, trekëndësh me një faqe anësore cilindrike.
- *Masa e formës:* sipas kërkesave të AK.
- *Pamja e jashtme dhe e brendshme:* e formuar mirë, e pastër dhe pa njolla. Lejohen plasaritje të lehta në sipërfaqe. Në prerje është e njëllotë, e pastër, pa lëndë të huaja me sythe teknike, me ngjyrë të bardhë deri në krem.
- *Struktura dhe konsistenca:* e lëmuar, e butë dhe pa dallim shtresash.
- *Era dhe shija:* E këndshme, specifike e djathit të butë të stazhionuar, pa shije të hidhur dhe djegëse, pa shije e erë të huaj.

Treguesit fiziko kimikë:

- *Lagështira në %*, jo më shumë se:
  - o Për periudhën 1.05- 30.09, në %“52”.
  - o Për periudhën 1.10.- 30.04, në %“56”.
- *Lëndët e thata në %*,jo më pak se:
  - o Për periudhën 1.05- 30.09, në %“48”.
  - o Për periudhën 1.10.- 30.04, në %“44”.
- *Yndyra në lëndët e thata në %*, jo më pak se 50.
- *Kripë në %* deri 4 ±1.
- *Ngarkesa mikrobike*, brenda normave të lejuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Në çdo parti djathi lejohen deri në 5 % copa dhe 2 % thërrime, masa e një copë më e madhe ose e barabartë me 50 gr.

**Analiza mikrobiologjike (bazuar ne urdhrin nr. 645, datë 23.12.2016).**

#### **Ambalazhimi, marketimi dhe etiketimi**

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjenike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit me masa sipas kërkesave të AK-së. Djathi në ambalazh qëndron i mbuluar me shëllirën fillestare, e cila përmban 10-14 % kripë deti.

Mbi çdo ambalazh me djathë vendoset etiketa në të cilën shënohen:

- Emërtimi i prodhuesit
- Emri i produktit

- Cilësia
- Pesha neto ose vëllimi i produktit
- Data e prodhimit
- Data e skadencës
- Kushtet e veçanta të ruajtjes
- Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë. këto të dhëna të jepen mbi amballazh ose mbi etiketë.

### **Verifikimi i kërkesave cilësore**

Marrja në dorëzim e djathërave të butë bëhet me parti. Parti quhet sasia e djathit e prodhuar në kushte të njëjta, nga i njëjti djath prodhues dhe që dorëzohet njëherësh.

Malli duhet të shoqërohet me raport analizë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

**Raport analiza Fiziko-Kimike duhet të përmbajnë treguesit fiziko-kimikë të mësipërm.**

**Raport analiza Mikrobiologjike duhet të përmbajë treguesit sipas legjislacionit në fuqi .**

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” dhe Raport Analiza “Mikrobiologjike” duhet të paraqitet në origjinal, ose fotokopje të noterizuara.

### **Ruajtja dhe transporti**

Djathërat e butë ruhen në frigorifer në temperaturë +3 deri +5 °C, e lagështirë relative të ajrit rreth 95%. Koha e ruajtjes në këto kushte është deri në 12 muaj.

Transportimi i djathërave të butë nga një rreth në tjetrin bëhet me mjete frigoriferike, ndërsa brenda rrethit transportimi i tyre me mjete të zakonshme të mbuluara e të pastra të cilat janë të destinuara për transportimit e prodhimeve ushqimore.

## **2. GJALP ME KRIPË**

**Bazuar në SSH 1445:1987 ose ekuivalentin e tij.**

*Bazuar në Urdhrin e Ministrisë së Bujqësisë Nr. 645, dt. 23.12.2016, Për zëvendësimin e aneksit I, të Urdhrit nr. 234, datë 20.05.2014, Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”.*

### **Klasifikimi:**

- **Gjalpë me kripë me cilësi të parë**
- **Lloji: Lope**

### **Kërkesat cilësore**

Treguesit shqisorë:

- *Pamja:* E njëtrajtshme, pa shtresa, në prerje e sipërfaqe të shëndritur pa pika uji dhe mbeturina dhalli.
- *Ngjyra:* E bardhë deri në të verdhë, karakteristike e kremës nga e cila prodhohet, e njëllojtë në të gjithë masën.
- *Era dhe shija:* E këndshme, karakteristike e gjalpës, lehtësisht e kripur. Pa erë dhe shije të huaj.
- *Konsistenca në temperaturë 10-12 °C:* gjysmë e fortë.

Treguesit fiziko-kimik:

- *Lagështia në %*, jo më shumë se 17.
- *Yndyrë në %*, jo më pak se 79.
- *Lëndët e thatë pa yndyrë në %*, jo më shumë se 2.



- Aciditeti i shprehur në gradë Ketshtofer jo më shumë se 5.
- Ngarkesa mikrobike brenda normave të lejuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

### **Analiza mikrobiologjike (bazuar urdhri nr. 645, dt.23.12.2016).**

#### **Ambalazhimi dhe markëtimi**

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit. Ambalazhimi të bëhet në letër pergamen ose qese polietileni me vëllime sipas kërkesave të AK.

Mbi çdo ambalazh me gjalp vendoset etiketa në të cilën shënohen:

- Emërtimi i prodhuesit
- Emri i produktit
- Cilësia
- Pësia neto ose vëllimi i produktit
- Data e prodhimit
- Data e skadencës
- Kushtet e veçanta të ruajtjes
- Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë. këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

Paketat e gjalpit vendosen në arka ose kuti kartoni, druri ose plastike dhe mbi secilën prej tyre vihet etiketa në të cilën shënohen të dhënat e mësipërme.

#### **Verifikimi i kërkesave cilësore**

Kërkesat cilësore verifikohen për çdo parti gjalpi. Parti është sasia e gjalpit e prodhuar në kushte të njëillojta, nga i njëjti prodhues e të njëjtit lloj dhe që dorëzohet njëherësh.

Malli duhet të shoqërohet me raport analizë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

**Raport analiza Fiziko-Kimike duhet të përmbajnë treguesit fiziko-kimikë të mësipërm.**

**Raport analiza Mikrobiologjike duhet të përmbajë treguesit sipas legjislacionit në fuqi.**

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” dhe Raport Analiza “Mikrobiologjike” duhet të paraqitet në origjinal, ose fotokopje të noterizuara.

#### **Ruajtja dhe transportimi**

Gjalpi ruhet në frigorifer. Nuk lejohet ruajtja e gjalpit së bashku me produktet që janë burim infeksioni ose që kanë erë specifike.

Afati i ruajtjes për gjalpin e kripur në temperaturën -18°C është 1 vit.

Transporti bëhet me mjete të pastra, frigoriferike, të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

### **3. QUMËSHT ME GJYSËM YNDYRË I STERIZUAR**

#### **Bazuar ne SSH 1563:1987 ose ekuivalentin e tij.**

*Bazuar ne SSH 1563/87, Ligjin Nr. 9441, datë 11.11.2005 “Për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregëtimin e qumshtit dhe të produkteve me bazë qumshti”.*

*Urdher i Ministrisë së Bujqësisë Nr 645, dt. 23.12.2016 “ Për zëvendësimin e aneksit I, të Urdhërit nr. 234, datë 20.05.2014, Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”.*

## **Kërkesat cilësore:**

### **Detyrimisht i pasterizuar dhe i sterilizuar.**

Gjate përpunimit dhe tregtimit të zbatohen rregullat higjeno- sanitare e veterinare në fuqi.

Nuk duhet të lejohet përdorimi i lëndëve konservuese, neutralizuese dhe të huaja.

Të plotësojë treguesit organo-leptikë dhe ato fiziko-kimike.

Treguesit cilësorë:

- *Pamja e jashtme:* Të jetë lëng i njëllajtë (homogjen), pa lëndë të huaja që duken e notojnë ose bien në fund.
- *Ngjyra:* e bardhë, e njëllajtë me nuance të verdhë të lehtë.
- *Shija:* e këndshme, lehtësisht e ëmbël, me shije të lehtë zierje pa shije dhe erë të huaj.

Treguesit fiziko-kimikë:

- *Dendësia në 20 °C* jo më pak se 1.029 gr/litër.
- *Pika e ngrirjes* jo më e lartë se  $-0,520^{\circ}\text{C}$ .
- *Përmbajtja e yndyrës në %*,  $2\% \pm 0.1$ .
- *Aciditeti ne gradë Tjorner:*
  - o *Në periudhën 01 Tetor – 31 Mars:* jo më i lartë se 20.
  - o *Në periudhën 01 Prill – 30 Shtator:* jo më i lartë se 21.
- *Përmbajtja e lëndës së thatë, pa yndyrë,* jo më pak se 8.5 %
- *Prova e pasterizimit (e fosfatazes dhe peroksidezes)* duhet negative.
- *Mikroelementet, mg/l* jo me shume se:
  - o Arseniku: 0.1
  - o Bakri: 0.5
  - o Plumbi: 0.2
  - o Zinku: 5
- Pastërtia pa mbetje me sitë mëndafshi apo merlë pambuku dyfishe.

### **Ambalazhimi dhe etiketimi**

Ambalazhimi brenda kushteve higjeno-sanitare, në ambalazhim tetrapak, me vëllim sipas kërkesave të AK-së, ku të jenë vendosur:

- Emërtimi i prodhuesit,
- Emri i produktit,
- Peshë neto ose vëllimi i produktit,
- Data e prodhimit,
- Data e skadimit,
- Përqindja e yndyrës,
- Temperatura e ruajtjes së produktit.

Materialet që përdoren për ambalazhet e qumështit duhet të jenë sipas normave teknike dhe higjeno-sanitare të përcaktuara në standardet përkatëse.

### **Analiza mikrobiologjike bazuar në Urdherin e Ministrisë të Bujqësisë Nr 645, dt. 23.12.2016**

- Aerobe mezofil  $< 1$

### **Ruajtja dhe transportimi**

Kushtet e veçanta të ruajtjes: në temperaturë 2 deri në 8 gradë.

Transportimi i qumështit bëhet me mjete të specializuara, të caktuara për transportimin e qumështit. Transportimi bëhet sa më shpejtë, në kohë të freskët, natën ose në orët e para dhe të vona të ditës.

Qumështi meret në dorëzim me parti që është sasia e qumështit të një lloji dhe që dorëzohet njëherësh.

#### **Verifikimi i kërkesave cilësore**

Malli duhet të shoqërohet me raport analizë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

#### **Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.**

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” dhe Raport Analiza “Mikrobiologjike” duhet të paraqitet në origjinal, ose fotokopje të noterizuara.

#### **4. KOS**

##### **Bazuar në SSH 1443:1987 ose ekuivalentin e tij.**

*Bazuar në Urdhrin e Ministrisë së Bujqësisë Nr. 645, dt. 23.12.2016, Për zëvendësimin e aneksit I, të Urdhrit nr. 234, datë 20.05.2014, Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”.*

##### **Klasifikimi**

- **Me yndyrë 2 %, cilësi e parë**
- **Lloji: Lope**

##### **Kërkesat cilësore**

Treguesit shqisorë:

- *Ngjyra:* e bardhë, në sipërfaqe e bardhë lehtësisht në krem.
- *Struktura:* e ngjeshur, pa pore, në prerje pa shtresa dhe ndarje hirre.
- *Era dhe shija:* e këndshme, karakteristike e kosit të ëmbël, lehtësisht e thartë.

Treguesit fiziko-kimikë:

- *Aciditi në gradë Tjorner,* jo më shumë se 120.
- *Yndyra në %,  $2 \pm 0.1$ .*
- *Ngarkesa mikrobiale* sipas normave të miratuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

##### **Analizë mikrobiologjike (bazuar në urdhrin nr. 645, datë 23.12.2016).**

- **Enterobacteriaceae < 10 cfu/ml**

##### **Ambalazhimi, marketimi dhe etiketimi**

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit. Kosi ambalazhohet në paketime plastike me grykë të gjerë ose me ambalazhime plastike të mbyllura me kapak sipas kërkesave të AK-së.

Ambalazhet që përdoren të jenë në gjendje të mirë, të pastër, të thata dhe pa erë të huaj.

Materiali që përdoret për ambalazhim duhet të jetë sipas normave teknike dhe higjeno-sanitare nga standardet përkatëse.

Në çdo paketim vendoset etiketa ku shënohet:

- Emri i ndërmarrjes prodhuese,

- Përqindja e yndyrës,
- Pesha neto ose vëllimi i produktit,
- Data e prodhimit,
- Data e skadimit,
- Kushtet e veçanta të ruajtjes.

### **Verifikimi i kërkesave cilësore**

Marrja në dorëzim bëhet në parti. Parti konsiderohet sasia e kosit që dorëzohet njëherësh.

Duhet të shoqërohet me raport analizë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

### **Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.**

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” dhe Raport Analiza “Mikrobiologjike” duhet të paraqitet në origjinal, ose fotokopje të noterizuara.

### **Ruajtja dhe transportimi**

Kosi ruhet e tregtohet në frigorifer në temperatura nën 10 °C dhe në mungesë të tyre mbahet në mjedis të freskët dhe të ajrosur. Koha e ruajtjes në frigorifer është 24 orë nga koha e prodhimit.

## **VEZË**

### **1.VEZË**

#### **Bazuar në SSH 325-1 :1993 ose ekuivalentin e tij.**

*Bazuar në Rregulloren nr. 1 datë 25.05.2005 të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe në zbatim të rregullores CEE Nr. 1907/90 të Këshillit për normat e tregtimit për vezët, në udhëzimin Nr. 21 datë 25.11.2010 të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, dhe bazuar në Urdhrin e Ministrisë së Bujqësisë Nr. 645, dt. 23.12.2016, Për zëvendësimin e aneksit I, të Urdhrit nr. 234, datë 20.05.2014, Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”.*

### **Klasifikimi**

- **Masa në gram:**
  - o më pak se 53 gr. (S)
  - o 53 gr e më tepër dhe jo mbi 63 gr. (M)
  - o 63 gr dhe jo më tepër se 73 gr. (L)

### **Kërkesat cilësore**

- *Pamja e jashtme:* e pastër dhe pa plasje. Lejohen ndotje të lehta.
- *Dhoma e ajrit (lartesia) mm:* jo më shumë se 9 mm.
- *E bardha e vezës.* E dendur e kulluar dhe e pastër pa njolla gjaku ( të kontrolluar në ovoskop).
- *E verdha e vezës.* Kompakte e ndodhur në pozicionin qendror pak e levizshme. Lejohet devijim i vogël nga pozicioni qendror.
- *Era:* pa erë prishje dhe erë tjetër të huaj.
- Ç’do kokërr duhet të jete e vulosur ku të përmbaje markën dhe datën e sakdencës.

Gjithashtu duhet që çdo parti malli të shoqërohet me raport analizë ku kjo e fundit të përputhet me datën dhe markën e vulës.

### **Analiza mikrobiologjike (bazuar në urdhrin nr. 645, datë 23.12.2016).**

### **Amballazhimi dhe etiketimi**

Vezët ambalazhohen në kartona fole me kapacitet sipas kërkesave të AK.

Mbi çdo ambalazh vendoset etiketa ku shënohen:

- Emri i ndërmarrjes prodhuese,

- Sasia,
- Data e skadencës.

### **Verifikimi i kërkesave cilësore:**

Produkti duhet të shoqërohet me raport analizë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

Raport Analiza “Mikrobiologjike” duhet të paraqitet në origjinal, ose fotokopje të noterizuara.

- Transporti bëhet me mjete të pastra, frigoriferike, të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë.

Argumentim: Në bazë të nenit të 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP te ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion kërkesat e cilesise për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

### **Kushtet e furnizimit**

Furnizimi me produktin ushqimor Kos, cilësi e parë, 2% yndyrë (ambalazh plastik më i madh se 1 kg), do të bëhet çdo ditë sipas kërkesave të institucionit tone.

Ndërsa furnizimi me produkte ushqimore:

- 1- Djathë i bardhë fetë Lope, cilësi e parë.
- 2- Gjalp me kripë Lope, cilësi e parë.
- 3- Qumësht me qysëm yndyrë i sterilizuar (ambalazh tetrapak 1 litër)
- 4- Veze.

Do të bëhet minimalisht një herë në javë sipas kërkesave të institucionit tone.

### **Shenim për operatorët ekonomikë:**

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike<sup>1</sup>. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.”

Gjithashtu risjellim ne vemendje se:

- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t'i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit përmbushes për këto pika do të jetë kusht skualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor mund të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht skualifikimi.
- Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose të kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

### **Njësia e Prokurimit**

- |           |            |   |
|-----------|------------|---|
| 1. Bledar | HOXHALLARI | anetar (përgjegjes i prokurimit publik) |
| 2. Entela | MADHI      | anetare (specialiste e fushes)          |
| 3. Entela | BARDHI     | anetare                                 |